



Qeveria "Rama 4"
- Rikonfirmime
dhe emra të rinj.
Andis Salla, do të
jetë ministër
i Bujqësisë

Faqe 2



Qeveria, plan
2 miliardë euro
për rritjen e
prodhimit
vendas

Faqe 2



AZHBR me
ekspertët e BE-së,
diskutime për
menaxhimin e
IPARD III

Faqe 5



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit shtator 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 517
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

METROLOGJIA NJË ÇELËS PËR EKSPORTE TË SIGURTA NË TREGJET E BE-SË

PËRAFRIMI I LIGJIT SHQIPTAR PËR METROLOGJINË ME KËRKESAT E BE-SË: NJË HAP STRATEGJIK PËR INTEGRIM DHE TREGTI TË DREJTË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

GQSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Sigurimi i fermerëve, kush përfshihet në skemë?
- Pagesat/ 9,600 lekë sigurim shoqëror në fushë, 7,350 lekë në malësi

Faqe 5

STANDARDE

4 vite burg për tregtimin e ushqimeve të dëmshme!
- Siguria ushqimore, ashpërsohen masat me Kodin e ri Penal



Faqe 5

INTEGRIM

Çelja e grupkapitujve me BE
- Pas Grupkapitullit 4, ekspertët apelojnë për vëmendje tek Bujqësia



Faqe 2

BASHKËPUNIM



Hapet në Tiranë Java Kulturore e Arabisë Saudite, arti e tradita e një vendi i gjithi për t'u zbuluar

Faqe 6

TEMA TË DITËS

- Gratë punojnë, burrat drejtojnë agrobizneset - Trendi po ndryshon, rritet ambicia e gjinisë femërore për të menaxhuar Fq.6
- Fermerët e Myzeqesë rrezikojnë eksportet, pesticidet e ndaluara dhe mungesa e udhëzimeve rrisin shqetësimet për prodhimet Fq.7
- Kujdesi për bagëtitë në dimër, blegtorët përgatisin bazën e duhur ushqimore Fq.7
- Në Divjakë rinisin eksportet - Fermerët vendosin etiketa, eksportuesit ankohen për kostot e larta të analizave Fq.10
- Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban - Prof. As. Dr. Eqrem & Ema Meçollari Fq.13

TEMA TË DITËS

Çelja e grupkapitujve me BE - Pas Grupkapitullit 4, ekspertët apelojnë për vëmendje tek Bujqësia

Ndërsa pritet të zyrtarizohet me konferencën ndërqeveritare çelja e Grupkapitullit 4, për grupkapitullin 5 – Bujqësia,

isë shqiptare me ato të Bashkimit European. Kjo kërkon kapacitete të mjaftueshme për të realizuar këtë lloj gjurmimi

kuptuar drejt, mendon eksperti i Integritimit Gajo.

“Nuk jam për rritje prodhimi dhe të mbështetjes së drejt-përdrejtë të fermerit, por jam për sigurinë mjedisore dhe ushqimore, pra që indirekt të prodhohen, por brenda kushteve dhe standardeve mjedisore dhe veterinare, kur bëhet fjalë për prodhimet blegtorale”, thotë ai.

Nga ana tjetër, në rastet e lejimit të kohës së quajtur tranzicion, pra përtej anëtarësimit, Gajo gjykon se plani për këtë duhet të jetë gjithashtu shumë i detajuar.

“Nuk është një diçka që t’i thuash: unë do të marr një periudhë 5 apo 10-vjeçare pas tranzicionit, por duhet të kesh një plan shumë të detajuar kohor, të mirëpërcaktuar, me masa dhe objektiva të qarta, në mënyrë që ai të jetë i besueshëm dhe të realizohet brenda asaj periudhe për të cilën je përgatitur, dhe ke kapacitetet e mundshme dhe objektivat politike”, thekson Gajo.



ekspertët kërkojnë vëmendje për specifikat përkatëse.

“Bujqësia dhe kohezioni rajonal janë dy nga sektorët që normalisht mbështeten më shumë nga fondet e BE-së dhe duhet të adoptohen politikat që kanë mbështetje të qever-

dhe analize që do t’i bëhet të gjithë tregut shqiptar dhe mbështetjeje që do të vijnë pikërisht për të krijuar këtë lloj sistemi”, thotë eksperti i Integritimit, Albert Gajo.

Por, karakteristika kryesore e fondeve mbështetëse duhet

Qeveria, plan 2 miliardë euro për rritjen e prodhimit vendas

Qeveria e re e sapomiruar në Kuvend ka prezantuar një plan ambicioz për 4 vitet e ardhshme, për të nxitur investimet dhe zhvillimin ekonomik në vend, duke mobilizuar mbi 2 miliardë euro kredi dhe garanci për bizneset. Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare të Zhvillimit, synohet rritja e prodhimit vendas dhe përmirësimi i klimës së biznesit.

Një fokus i veçantë do t’i kushtohet zhvillimit të zonave malore, ku përmes Paketës së Maleve do të lehtësohet marrja e lejeve të ndërtimit dhe do të ofrohet përfitim taksash dhe TVSH zero për dhjetë vitet e para për 500 investitorët e parë. Kjo është një nismë që synon të sjellë investime të qëndrueshme dhe punësim në zonat më pak të zhvilluara.

Një tjetër hap i rëndësishëm është krijimi i sistemit të Byrove të Kreditit (Credit Bureaus), që do të ndikojë në uljen e rreziqeve për bankat dhe bizneset.

Po ashtu, parashikohet heqja e çmimeve të referencës për importet nga Bashkimi European, hap ky që pritet të ulë kostot dhe lehtësojë tregtinë.

Përmes Strategjisë së Specializimit Inteligent, me një buxhet prej 1,18 miliardë euro, qeveria synon të mbështesë projektet e reja të teknologjisë dhe të lidhë më fort ekonominë shqiptare me tregjet europiane, duke ndihmuar bizneset

të rriten dhe të konkurrojnë në nivel ndërkombëtar.

Për të siguruar një klimë investimi më të sigurt, ligjet do të përafrohen me standardet e BE-së, duke mbrojtur patentat, markat dhe të drejtat e autorit.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të kenë akses më të lehtë në fonde dhe kredi zhvillimi, duke rritur produktivitetin dhe punësimin lokal.



Për eksportuesit do të ketë programe mbështetëse që ndihmojnë për t’u përshtatur me kërkesat e tregut unik european, ndërsa certifikatat shqiptare do të njihen në të gjithë Bashkimin European falë përmirësimit të infrastrukturës së kontrollit të cilësisë.

Në kuadër të reformave, do të forcohet mbrojtja e konsumatorit me ligje të reja që garantojnë sigurinë e produkteve, ndërsa institucionet e biznesit dhe inspektoratet do të riorganizohen për të qenë më transparente, efikase dhe më pak burokratike.

Kjo paketë masash synon të krijojë një ambient më të favorshëm për biznesin dhe të

mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë në vitet në vijim.

Shqipëria ka bërë hapa përpara për të krijuar një klimë më të favorshme për sipërmarrjen, duke ulur barrën fiskale për bizneset e vogla, thjeshtuar procedurat dhe rritur konkurrueshmërinë e tregut vendas në raport me rajonin dhe Bashkimin European.

Një nga masat më të rëndë-

sishme ka qenë rritja e pragut të TVSH-së në nivelin më të lartë në rajon, duke përjashtuar shumicën e bizneseve të vogla nga kjo detyrë. Sot, vetëm 27% e bizneseve janë subjekt i TVSH-së, ndërsa pjesa tjetër përfitojnë nga politika lehtësuese që i ka liruar nga kjo barrë fiskale.

Gjithashtu, u ndërmor një reformë e thellë për tatimin mbi të ardhurat e bizneseve të vogla: u eliminua tatimi për bizneset me xhiro deri në 14 milionë lekë, duke përjashtuar 90% të bizneseve të vogla dhe duke u lënë sipërmarrësve në dispozicion rreth 17 miliardë lekë çdo vit për të investuar dhe zgjeruar aktivitetin e tyre.

Qeveria “Rama 4” - Rikonfirmime dhe emra të rinj. Andis Salla, do të jetë ministër i Bujqësisë

Ambicia për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European në vitin 2030 është reflektuar edhe në qeverinë e re socialiste.

Kryeministri Edi Rama prezantoi kabinetin e ri në Asambleen Kombëtare të Partisë Socialiste, përbërja e të cilit pësoi ndryshime të rëndësishme, me disa rikonfirmime, largime nga postet ministrore, si dhe emra të rinj.

Belinda Balluku do të vijojë të mbajë postin e zëvendëskryeministres dhe të Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë. Po ashtu, edhe Petrit Malaj do të vijojë të shërbejë si Ministër i Financave, ndërsa në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes është rikonfirmuar Pirro Vengu.

Janë 8 ministra të cilët nuk do të jenë pjesë e qeverisë Rama 4, konkretisht: Ervin Hoxha, Igli Hasani, Ulsi Manja, Ogerta Manastirliu, Anila Denaj, Bora Muzhaqi, Arbjan Mazniku dhe Taulant Balla.

Ndërkohë, emra të rinj do të futrn në kabinetin “Rama 4”, për marrë drejtimin e disa ministrive të rëndësishme, sikurse është propozimi i emrit të Ervis Salës në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, Andis Salla në krye të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Besfort Lamallari te Ministria e Drejtësisë.

Për herë të parë në kabinetin qeveritar do të ketë një ministre virtuale. Prokurimet Publike do të zhvillohen përmes Inteligjencës Artificiale (AI) nga asistentja virtuale e e-Albania, “Diella”. Rama tha se “Diella” do të ketë në mbështetje një strukturë të posaçme për adoptimin e Inteligjencës Artificiale në proceset qeverisëse.

Ndërkohë, Turizmi dhe Sporti do të bashkohen në një ministri me Kulturën, ndërsa Mjedisi është ndarë si ministri më vete, që do të drejtohet nga Sofjan Jaupaj.

Zv.kryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku
Ministër i Punëve të Brendshme, Albana Koçi
Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, Elisa Spiropali
Ministër i Financave, Petrit Malaj
Sofjan Jaupaj, Ministër Mjedisi
Blendi Gonxhja, Ministër i Turizmit dhe Kulturës, Sportit
Mirela Kumbaro, Ministre e Arsimit
Evis Salla, Ministre e Shëndetësisë
Delina Ibrahimaj, Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit
Besfort Lamallari, Ministër i Drejtësisë
Pirro Vengu, Ministër i Mbrojtjes
Andis Salla, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ervin Demo, Ministër i Shtetit për pushtetin Vendor
Adea Pinderi, Ministre e Shtetit për Administratën Punlike dhe Antikorrupsionin
Majlinda Dhuka, Kryenegociatore
Toni Gogu, Ministër i Marrëdhënieve për Parlamentin



Gonxhja: Programi zviceran “VET by EHL”, rrugë e re për profesionistët e sektorit të turizmit

Të rinjtë shqiptarë kanë mundësinë të ndjekin arsim profesional me standarde ndërkombëtare përmes programit “VET by EHL”, një iniciativë që realizohet në partneritet me shkollën prestigjioze zvicerane EHL (Ecole hôtelière de Lausanne).

Programi ofron formim profesional në fushën e hotelieri-turizmit, me mësim të zhvilluar në gjuhën angleze dhe me fokus në përgatitjen praktike, sipas modelit zviceran të arsimit dual.

Studentët pajisen me aftësi të kërkuara nga tregu i punës, duke përfituar mundësi të shumta punësimi brenda dhe jashtë vendit.

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja bëri të ditur se të gjithë të interesuarit mund të regjistrohen dhe të bëhen pjesë e këtij

programi që sjell një qasje moderne dhe të integruar në arsimin profesional në Shqipëri.

“Regjistrohu në arsim profesional në programin VET by EHL, në partneritet me shkollën zvicerane – EHL. Fito një profesion në hotelieri-turizëm me standarde ndërkombëtare, mësim në anglisht dhe plot mundësi punësimi”, theksoi ministri.

Mbi 60% e nxënësve të arsimit profesional punësohen në bankat e shkollave, qoftë gjatë vitit të tretë të studimeve apo brenda 6 muajve pas përfundimit të tyre, sipas të dhënave nga studimet dhe anketimet e realizuara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. Në degë të veçanta si hotelieri-turizmi, ky tregues arrin deri në 80%.

Për të mbështetur nxënësit, veçanërisht ata nga familjet me

të ardhura të ulëta, ofrohen mbi 2500 bursa sociale deri në 7320 lekë në muaj.

Procesi i aplikimit për klasën e 10-të kryhet përmes “e-Albania”-s, ku çdo prind mund të aplikojë online dhe më pas merr përgjigjen nga shkolla.

Arsimi i mesëm profesional u ofron nxënësve mundësi kualifikimi dy, tre dhe katërvjeçar, dhe i përgatit ata për profesione specifike, nëpërmjet zhvillimit të aftësive praktike dhe njohurive të aplikueshme.

Arsimi i mesëm profesional u ofron të rinjve mundësi kualifikimi në nivelet II, III dhe IV të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, duke i përgatitur si punonjës të kualifikuar dhe teknikë të mesëm në fusha të ndryshme.

METROLOGJIA NJË ÇELËS PËR EKSPORTE TË SIGURTA NË TREGJET E BE-SË

PËRAFRIMI I LIGJIT SHQIPTAR PËR METROLOGJINË ME KËRKESAT E BE-SË: NJË HAP STRATEGJIK PËR INTEGRIM DHE TREGTI TË DREJTË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Metrologjia është shkenca që siguron që çdo kilogram, litër apo gradë të matet drejt – duke mbrojtur konsumatorin, duke ndihmuar bizneset dhe duke krijuar transparencë në treg. Ajo është një nga shtyllat e Infrastrukturës së Cilësisë dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndet, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik. Metrologjia siguron që matjet të jenë të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të pranueshme kudo. Kjo redukton humbjet, nxit inovacionin dhe hap rrugën për tregti të ndershme brenda dhe jashtë vendit.

Në Shqipëri, autoriteti përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) (www.dpm.gov.al). Ajo ruan etalonet kombëtare, kalibron dhe verifikon instrumentet matëse (peshore, matës volumorë, termometra, matës presioni etj.), si dhe kontrollon produktet e parapaketuara. DPM siguron që matjet në vend të jenë të sakta dhe të besueshme.

Metrologjia në shërbim të fermerëve dhe agrobizneseve

Fermerët dhe NVM-të agro-ushqimore përdorin çdo ditë shërbime metrologjike. Peshoret, matjet e lagështisë, temperaturës dhe presionit, si dhe kontrolli i sasive neto të produkteve të parapaketuara janë pjesë e pandashme e aktivitetit të tyre. Por pse ka rëndësi që këto instrumente të jenë të verifikuara apo të kalibruara? Sepse një instrument jo i saktë sjell pasoja të shumta:

- Humbje ekonomike për fermerin: një peshore që tregon më pak, i ul të ardhurat; një termometër i pasaktë në magazinë mund të dëmtojë prodhimin.
- Rrezik për konsumatorin: matjet e gabuara në përpunimin ushqimor apo ruajtjen e produkteve cenojnë sigurinë ushqimore.
- Pengesa për eksportin: tregjet e BE-së nuk pranojnë produkte që nuk shoqërohen me prova matjesh të gjurmueshme dhe të njohura ndërkombëtarisht.
- Mungesë besimi: pa instrumente të sakta, marrëdhënia mes fermerit, tregtarit dhe konsumatorit humb transparencën dhe besueshmërinë.

Verifikimi dhe kalibrimi i instrumenteve është një investim në besim, cilësi dhe tregti të qëndrueshme.

Shërbime të DPM me interes për bujqësinë dhe agrobiznesin

Fusha	Shembuj shërbimesh	Përfituesit kryesorë
Masa	Verifikimi i peshoreve jo-automatike (NAVI), kalibrimi i gramarëve	Fermerë, tregje, pika grumbullimi
Volume	Kalibrimi i mikropipetave, enëve volumore, kalibrim dhe verifikim i depozitave (inoks, plastike)	Përpunues ushqimorë, fabrika vajrash/vere, laboratorë
Temperaturë & Lagështi	Kalibrimi i termometrave dhe higrometrave për magazina e frigoriferë	Magazinim ushqimor, sera, eksportues fruta-perime
Presion & Forcë	Kalibrimi i manometrave, matësve të presionit dhe makinave të provës	Agro-industri, laboratorë ushqimorë
Produkte të parapaketuara	Kontrolli i sasive neto në paketim	Fabrika ambalazhimi, përpunues ushqimorë

3. UNIDO dhe DPM: drejt një kuadri ligjor modern për matjet

Nga 24 deri më 29 gusht 2025, në Tiranë u mbledh grupi i punës për rishikimin e Ligjit nr. 126/2020 “Për Metrologjinë” dhe akteve nënligjore përkatëse, me synimin për ta përafëruar legjislacionin kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

Aktiviteti u mbështet nga UNIDO si pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet Sekretariatit të saj Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), përmes angazhimit të ekspertës ndërkombëtare Katarína Surmíková Tatranská.

Znj. Surmíková Tatranská është një profesioniste me përvojë mbi 20-vjeçare në fushën e metrologjisë, standardizimit dhe politikave të infrastrukturës së cilësisë. Si ish-presidente ekzekutive e Zyrës Shtetërore të Standardizimit, Metrologjisë dhe Testimit në Sllovaki, ajo ka udhëhequr reforma të rëndësishme kombëtare, ka promovuar digjitalizimin e metrologjisë dhe standardizimit dhe ka përfaqësuar vendin e saj në organizata kryesore si ISO, IEC, CEN, CENELEC dhe OIML.

Në Shqipëri, roli i saj ishte thelbësor për identifikimin e boshllëqeve ligjore në Ligjin për Metrologjinë dhe aktet nënligjore ekzistuese, analizimin e praktikave më të mira të vendeve anëtare të BE-së



drejtoresha e përgjithshme e DPM, znj. Alkida Llakaj, theksoi se ky proces është vendimtar për modernizimin e shërbimeve të metrologjisë dhe për rritjen e sigurisë e transparencës në treg, si për konsumatorët ashtu edhe për agrobizneset.



Ndryshimet e propozuara nga ekspertja ndërkombëtare synojnë ta bëjnë ligjin për metrologjinë më të qartë, më të drejtë dhe më afër standardeve të BE-së, duke ndikuar drejtpërdrejt tek fermerët, bizneset dhe konsumatorët. Rekomandimet përfshijnë thjeshtimin e procedurave për bizneset përmes një sistemi unik autorizimi, forcimin e mbikëqyrjes



dhe përshtatjen e tyre për kontekstin shqiptar, si dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për amendime të mbështetura në praktikat ndërkombëtare. Raporti paraprak i saj evidentoi disa sfida kyçe: fragmentim të legjislacionit, mbikëqyrje të pamjaftueshme të tregut, mungesë koordinimi mes institucioneve, pajisje të vjetruara dhe mungesë financimi të qëndrueshëm për etalonet kombëtare. Këto mangësi, sipas saj, jo vetëm që pengojnë funksionimin e drejtë të tregut të brendshëm, por edhe dëmtojnë besueshmërinë ndërkombëtare të produkteve shqiptare.

Pas prezantimit të gjetjeve dhe rekomandimeve, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit theksoi se përafrimi i legjislacionit në metrologji është kusht i domosdoshëm për integrimin në tregun e BE-së dhe për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare. Në të njëjtën linjë,

INFORMACIONE

Më shumë se 330 fermerë aplikojnë kontrollin biologjik në serra për reduktimin e pesticideve

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën të ditur se përdorimi i kontrollit biologjik në prodhimin bujqësor në serra po jep rezultate shumë prem-tuese, duke ndihmuar në uljen e përdorimit të pesticideve dhe në ofrimin e produkteve më të sig-urta për konsumatorin.

MBZHR, bën të ditur se kon-trolli biologjik është një metodë natyrore që konsiston në lëshimin e organizmave të dobishëm, si

insekte që luftojnë në mënyrë të kontrolluar insektet e dëmshme.

Kjo alternativë është efikase, miqësore me mjedisin dhe shën-detësisht e sigurt për fermerët dhe konsumatorët.

Deri tani, më shumë se 330 fermerë në rreth 110 hektarë sipërfaqe serra e kanë aplikuar me sukses kontrollin biologjik në specia dhe domate.

Përfitimet kryesore nga aplikimi i Kontrollit Biologjik janë: produkte

të pastra dhe pa mbetje – standard më i lartë sigurie për konsumatorët; reduktim i pesticideve kimike – më pak rrezik për mjedisin dhe shëndet-in e fermerëve; rritje e konkurruesh-mërisë – bujqësia shqiptare afrohet me tregjet me vlerë të lartë të BE-së dhe më gjerë.

MBZHR i nxit fermerët ta adoptojnë këtë praktikë të qëndrueshme, si një hap të rëndë-sishëm drejt një bujqësie mode-rne, të pastër dhe konkurruese.

Praktika dhe punësim për studentët e UBT-së

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj dhe rektori i Universitetit Bujqë-

punësim për studentët e UBT-së, ofrimin e ekspertizës shkencore dhe konsulencës për politikat e



sor të Tiranës (UBT), Fatbardh Sallaku, firmosën në Tiranë, marrëveshjen e bashkëpunimit, që duke hapur një kapitull të ri në funksion të vizionit Bujqësia 2030.

Ky partneritet synon të krijojë ura të reja ndërmjet dijes aka-demike dhe praktikës në terren, duke i dhënë një shtysë të rëndë-sishme zhvillimit të bujqësisë dhe forcimit të zonave rurale.

Sipas ministres Denaj, mar-rëveshja parashikon praktika dhe

ministres nëpërmjet një meka-nizmi koordinimi që lidh arsimin me nevojat e sektorit, si dhe mundësi studimi me diplomë të dyfishtë UBT–BOKU.

“Kjo është një urë bashkëpun-i mi mes dijes dhe praktikës, që sjell më shumë mundësi për të rinjtë, mbështetje për fermerët dhe zhvillim të qëndrueshëm për bujqësinë shqiptare” u shpreh ministria Denaj gjatë nënshkrimit të marrëveshjes.

Ndërsa Prof. Sallaku në një

prononcim për ATSH-në, tha se “UBT do të jetë partneri krye-sor i Ministrisë së Bujqësisë për ofrimin e ekspertizës shken-core dhe konsulencës në fushat e bujqësisë, shkencave të tokës, ushqimit, zhvillimit rural, vet-erinarisë, akuakulturës dhe biote-knologjisë”.

“Një element i veçantë i kësaj marrëveshjeje është dhënia e vendeve vakante për praktikë profesionale në institucionet e MBZHR që do t’iu mundësojnë studentëve të UBT-së zhvillimin e aftësive dhe përvojës praktike në programe konkrete. Kjo nismë syn-on të krijojë një model bashkëpun-i mi të suksesshëm mes arsimit dhe sektorit bujqësor, duke kontribuar në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë shqiptare”, deklaroi Sallaku.

Ky hap konkret është pjesë e përpjekjeve për të modernizuar bujqësinë shqiptare, për të fuqizuar brezin e ri të profesionistëve në këtë sektor dhe për të garantuar një zhvillim të integruar rural në për-puthje me standardet evropiane.

Denaj: Tre instrumente financimi në bujqësi dhe agropërpunim

Fermerët, agropërpunuesit dhe sipërmarrësit në fushën e agroturizmit kanë tashmë akses më të lehtë në financim përmes tre instrumenteve të reja mbështetëse: Skema Kombëtare e Investimeve 2025, Kredia e Butë, dhe Garancia Sovrane.

Ministria e Bujqësisë dhe Zh-villimit Rural, Anila Denaj, dekla-roi se këto instrumente, pjesë e viz-ionit strategjik “Bujqësia 2030”, synojnë forcimin, modernizimin dhe rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor në Shqipëri.

“Këto instrumente konkrete financimi kthejnë idetë e in-vestimit në projekte të realizue-shme. Përmes një kombinimi të favorshëm të grantit, kredisë me interes të ulët dhe garancisë për kolateralin, ne i japim fund barrierave financiare që kanë penguar për vite me radhë in-vestimet në bujqësi dhe agrotur-izëm”, tha ministria Denaj.


Tre instrumentet kryesore për financim janë: granti deri në 50% përmes Skemës Kom-bëtare të Investimeve 2025; kredi e butë me interes vetëm

2% dhe Garancia Sovrane që mbulon 70% të kolateralit të kërkuar nga bankat.

Ky model i integruar finan-cimi synon të sigurojë mbulim të plotë të investimeve, duke e bërë më të lehtë për fermerët dhe sipërmarrësit të zhvillojnë aktiv-

itetin e tyre, të rrisin prodhimin dhe të hyjnë në tregje të reja.

Ministria theksoi se apli-kimet për këto instrumente do të hapen në fund të muajit shtator, ndërsa do të shoqëro-hen me sesione informuese në të gjitha qarqet e vendit.



Mbështetja nga skema kombëtare, blegtori: Zgjerova biznesin, djemtë lanë Anglinë për të punuar këtu

Mehmet Kadiu, nga fshati Çerkezë në Zall-Herr, prej vitesh i është përkushtuar mbarështimit të lopëve dhe sot kujdeset me pasion për tufën e tij me rreth 22 krerë, duke kontribuar në ekonominë familjare dhe atë lokale.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj nëpërmjet një postimi në rrjetet

sociale shkruan se “qumështi i freskët dhe cilësor që prodhon çdo ditë shkon në baxhot e zo-nës, ku përpunohet dhe shndër-rohet prodhime cilësore Made in Albania, duke rritur vlerën e produkteve shqiptare”.

Sipas Denajt, Kadiu “prej gjashtë vitesh është përfitues i Skemës Kombëtare të Sub-

vencioneve për mbarështimin e gjedhëve, mbështetje që i ka mundësuar të forcojë aktivite-tin e tij blegtoral”.

“Pasionin për këtë punë ia ka trashëguar edhe dy djemve, të cilët janë kthyer nga Anglia për të punuar në vendlindje dhe për të vazhduar traditën familjare”, shkruan Denaj.

UNIDO

Përafrimi i ligjit shqiptar për metrologjinë me kërkesat e BE-së: Një hap strategjik për integrim dhe tregti të drejtë

(Vijon nga faqja 3)

së tregut për të mbrojtur konsumatorin nga instrumentet e pasakta dhe rritjen e besuesh-mërisë së eksporteve shqiptare falë certifikatave të pranuara edhe jashtë vendit.

Një element tjetër i rëndësishëm është vendosja e një modeli të qëndrueshëm finan-cimi, që do t’i lejojë DPM-së të investojë vazhdimisht në laboratorë dhe pajisje moderne.



Këto masa nuk janë thjesht ndryshime në letra, por hapa konkretë për të ndërtuar një sistem matjesh më të ndershëm dhe më të besueshëm – një garanci që i shërben një-soj fermerit në fshat dhe biznesit që kërkon të hyjë në tregjet e Bashkimit Evropian. Me këtë mbështetje, Shqipëria po hedh hapat e parë drejt një kuadri ligjor modern, i cili do të ofrojë më shumë siguri për konsuma-torin, më shumë besueshmëri për bizneset dhe më shumë mundësi për eksportuesit shqiptarë në tregjet e BE-së.

Një plan 5-vjeçar për metrologji moderne

Në të njëjtën kohë, me mbështetjen e UNIDO dhe Institutin Zviceran të Metrologjisë – METAS, DPM ka hartuar një Udhëzues 2025–2030 që synon zgjerimin e kapaciteteve laboratorike, digjitalizimin e shërbimeve dhe njohjen ndërkombëtare të rezultateve.

Udhëzuesi synon të ndërtojë një infrastrukturë moderne matjesh që mbështet inova-cionin, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrueshmërinë e bizneseve shqiptare. Zbatimi i tij do të përkthehet në shërbime më cilësore e më të aksesueshme për fermerët, agrobizneset dhe NVM-të, duke u dhënë atyre mjete konkrete për të hyrë me besim në tregjet evropiane

Ky kombinim i reformës ligjore dhe vizionit strategjik afatgjatë e pozicionon Shqipërinë si një vend që jo vetëm përafrohet me acquis të BE-së, por ndërton një sistem modern metrologjie në shërbim të konsumatorit dhe biznesit.

Përfundim: Ndërtimi i një kulture të cilësisë në Shqipëri

Reformat në metrologji nuk janë vetëm ndryshime ligjore apo teknike – ato përk-thehen në përfitime konkrete për fermerët, bizneset dhe konsumatorët çdo ditë. In-strumentet matëse të certifikuara garantojnë që prodhimet bujqësore maten drejt dhe shiten me transparencë, duke rritur besimin mes palëve dhe duke forcuar sigurinë ushqimore.

Për fermerët dhe agrobizneset, matjet e sakta janë çelësi për të hyrë në tregjet e Bashkimit Evropian: produktet shqiptare do të shoqërohen me prova të pranueshme ndërkombëtarisht, duke hapur rrugë të reja për eksportin e produkteve bujqësore shqiptare.

Konsumatorët do të jenë më të mbrojtur ndaj mashtrimeve, ndërsa bizneset do të kenë më pak pengesa administrative dhe më shumë mundësi për rritje e konkurruesh-mëri. Me modernizimin e shërbimeve të metrologjisë, Shqipëria vendos një themel të fortë për një Kulturë të Cilësisë, ku çdo kilogram, çdo litër dhe çdo vlerë matet saktë dhe njihet kudo – duke sjellë më shumë siguri, besim dhe zhvillim për ekonominë shqiptare.

AKTUALITET

AZHBR me ekspertët e BE-së, diskutime për menaxhimin e IPARD III

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Bu-

himin e riskut dhe parandalimin e parregullsisve në kuadër të Programit IPARD III.

Seminari u zhvillua me pjesë-

në zbatimin e programit.

Kuçi tha se në fokus të takimit ishin: Mekanizmat e kontrollit dhe raportimit në administrimin e fondeve IPARD; praktikat më të mira për identifikimin dhe parandalimin e parregullsisve; përdorimi i mjeteve teknologjike për rritjen e transparencës dhe integritetit në proceset e menaxhimit.

Takimi shërbeu për shkëmbim përvojash me ekspertët evropianë. Ky aktivitet shërbeu si një platformë ndërinstitucionale për diskutimin e përbashkët të sfidave dhe zgjidhjeve në zbatimin e Programit IPARD III, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive dhe përvojave me ekspertët evropianë të fushës.

Drejtoresha Kuçi në fjalën e saj theksoi rëndësinë e angazhimit të të gjithë aktorëve në ruajtjen e standardeve të BE-së dhe sigurimin e një zbatimi transparent, efektiv dhe të qëndrueshëm të fondeve të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

AZHBR vijon të jetë një aktor kyç në garantimin e integritetit dhe besueshmërisë së programeve të financuara nga BE, duke rritur kapacitetet vendase për menaxhim të përgjegjshëm të fondeve dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë shqiptare.



jqësinë (DG Agri) dhe Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), organizoi një seminar të specializuar mbi menax-

marjen e drejtoreshës së AZHBR-së, Ardita Kuçi, si dhe të përfaqësuesve të Delegacionit të BE-së në Shqipëri e strukturave të përfshira

Pesticidet, prodhimi po bllokohet në serra. Fermerët të pakënaqur me grumbulluesit

Në një serrë me 6 tonë specia jeshilë, vjelja duhej të ishte kryer ditë më parë, por bllokimi i një sasie nga Sllovenia ka sjellë bllokimin zinxhir të gjithë prodhimeve shqiptare për eksport.

Pikat e grumbullimit nuk marrin më produkte vendase nga frika e kthimit të mallit, duke dëmtuar fermerët që thonë se duke mos e vjelë produktin, ai është i destinuar të kalbet.

“Kanë dy ditë që pikat e grumbullimit kanë mbyllur qepenat, sepse kanë frikë të marrin produktet tona,” tha fermeri nga Divjaka, Elton Sako.

Fermerët pretendojnë se nuk përdorin asnjë pesticid të ndaluar për bimët dhe ndjekin këshillat e agronomëve. Ata kërkojnë te kryhen kontrolle nga strukturat shtetërore, por jo të bllokohen shitja e të gjitha prodhimeve.

“Shteti t’i kontrollojë. Mos t’i lejojë të vijë. Ato [pesticidet] kanë një libër mbrapa, një fletë, që ne e lexojmë. Si thotë ajo, ne ashtu veprojmë,” u shpreh fermeri Ervis Lapi.

“Është problem kjo pjesë, se të digjemi në këtë moshë për dikë tjetër... Ne kërkojmë që Ministria e Bujqësisë të bëjë diçka,” tha fermeri Indrit Zaka.

Prodhimet bujqësore për eksport kanë kosto të lartë, ndaj sipas fermerëve nuk mund të përdorin vetëm preparate biologjike. Në rastet e pesticideve,

për çdo përdorim ata i referohen listës me emra të preparateve të lejuara nga Bashkimi European.

“Këto produkte që qarkullojnë të jenë pjesë e listës së PMB-së. Janë institucionet përkatëse

deklaroi fermeri Roland Londo.

Divjaka është zona me eksportin më të madh të perimeve drejt vendeve të BE-së. Mijëra tonë specia për momentin janë bllokuar pas kthimit të një sasie



të cilat duhet t’i kontrollojnë, edhe farmacitë bujqësore, që këto produkte të mos tregtohen,”

speci të kuq nga Sllovenia, që rezultoi nga analizat me përmbajtje të pesticideve të dëmshme.

Sigurimi i fermerëve, kush përfshihet në skemë? - Pagesat/ 9,600 lekë sigurim shoqëror në fushë, 7,350 lekë në malësi

Personat që punojnë në bujqësi si të vetëpunësuar kanë detyrimin të kontribuojnë për

nësuarit duhet të kenë tokë bujqësore në pronësi ose në përdorim sipas ligjit nr.

shërbimin shëndetësor. Për zonat fushore, kontributi tremujor për sigurim shoqëror është 9.600 lekë dhe 942 lekë për sigurim shëndetësor. Ndërsa për zonat malore, pagesa është më e ulët: 7.350 lekë për sigurim shoqëror dhe 942 lekë për shëndetësor.

Në listën e zonave fushore përfshihen qarqe si Tirana, Durrësi, Fieri, Lushnja apo Korça, ndërsa zonat malore janë Skrapari, Peshkopia, Kukësi, Tropoja dhe të tjera.

Ky sistem është menduar për t’i përfshirë fermerët në skemën e sigurimeve shoqërore dhe për t’u krijuar atyre të drejtën e pensionit, ndihmës ekonomike në raste të caktuara, si dhe mbrojtje shëndetësore. Por, pavarësisht detyrimit ligjor, pjesëmarrja e fermerëve mbetet e ulët. Sipas të dhënave, shumë bujq nuk i paguajnë rregullisht kontributet për shkak të të ardhurave të ulëta, çka rrezikon të ardhmen e tyre financiare.



sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Ligji parashikon që për t’u siguruar, ata duhet të kenë mbushur moshën 16 vjeç, të jenë të aftë për punë dhe të mos kenë punësim apo sigurim në sektorë të tjerë.

Sipas publikimit të bërë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore bujqit që përfitojnë statusin e të vetëpu-

7501, ose me akt noterial. Ata duhet të zhvillojnë aktivitet bujqësor apo blegtoral, duke jetuar në të njëjtin nënqark ku kanë tokën, ose në fshat edhe kur toka ndodhet në një qark fqinj.

Pagesat e sigurimeve kryhen çdo tre muaj dhe janë të detyrueshme, duke mbuluar pensionet, barrë lindjen dhe

4 vite burg për tregtimin e ushqimeve të dëmshme! - Siguria ushqimore, ashpërsohen masat me Kodin e ri Penal

Kodi i ri penal sjell shtimin e veprave penale që lidhen me sigurinë ushqimore, dhe konkretisht me prodhimin e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin, ofrimin e ushqimit të pasigurtë, mashtrimin me produktet ushqimore dhe paraqitjen e rremë të produktit ushqimor.

Referuar nenit 458 të draftligjit, “Prodhimi, përpunimi, ruajtja, tregtimi, importimi, eksportimi i ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera ushqimore, përdorimi i kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë në kundërshtim me standardet ligjore të lejuara, ose përdorimi i tyre të kafshët dhe bimët që përdoren si ushqim, në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke i bërë ushqimet të pasigurta për konsum, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në 4 vjet.

Vepra penale Ofrimi i ushqimit të pasigurtë kriminalizon therjen e kafshëve për shitje ose përdorimin e produkteve shtazore për konsum njerëzor, duke e ditur që atyre iu janë përdorur trajtime terapeutike me substanca të dëmshme. Dënimi në këtë rast shkon deri në 4 vjet burg. Është kriminalizuar gjithashtu hedhja për konsum publik e mishit ose produkteve të kafshëve të destinuara për ushqim, pa respektuar periudhat e pritjes, të para-

shikuara në ligj.

Sipas nenit 460 mbi mashtrimin me produktet ushqimore duke mos plotësuar ose ndryshuar kërkesat e përcaktuara në ligj për ska-

ushqimore duke mos plotësuar ose ndryshuar kërkesat e përcaktuara në ligj për ska-



more “Importimi, prodhimi, ruajtja, falsifikimi, publiciteti, tregtimi apo vendosja në qarkullim me ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, materialeve ose lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë, në të cilët janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, dënohet me burgim deri në tre vjet”.

Vepra penale Paraqitja e rremë e produktit ushqimor bën të ndëshkueshëm penalisht me burg deri në 6 muaj ofrimin në treg të produkteve

dencën ose përbërjen, fshehjen ose marrjen e produkteve ushqimore që synohen të bëhen të papërdorshme ose të dezinfektohen, me qëllim tregtimin e tyre.

Gjithashtu vepra penale Prishja e shenjave të organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore ndëshkon heqjen ose ndryshimin e shenjave bllokuese apo ushtrimin e aktivitetit pas bllokimit në kundërshtim me masat e përkohshme ose përfundimtare, të vendosura nga organet inspektuese të autoritetit kompetent të ushqimit, me qëllim prodhimin ose tregtimin e ushqimeve të pasigurta. Dënimi për këtë vepër është deri në 3 vite burg.

AKTUALITET

Bujqësia, e “etur” për financim - Sa iu përgjigjën bankat? BSH: Në korrik u dhanë rreth 28.6% më pak kredi për këtë sektor

Kredia në bujqësi i është rikthyer sërish rënies. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, bankat tregtare financuan më pak biznese të këtij sektori në muajin korrik.

Konkretisht, kredia e re për bujqësinë, pyjet dhe peshkimin ishte vetëm 189 milionë lekë, me një rënie prej 28.6% në krahasim me muajin qershor. Ndërkohë, stoku i kredisë ekzistuese, pra i atyre që kanë marrë kredi përpara korrikut dhe vijnë në treg në çdo muaj rezultojnë të jetë vetëm 6.2 miliardë lekë, me një rritje të lehtë nga muaji qershor si rezultat i interesave të papaguara ose rishtruktimit të kredisë, por me një rënie prej 1% krahasuar me muajin korrik të 2024.

Por pse bujqësia vijon të jetë një sektor i nënfinancuar nga bankat?

Bankat tregtare e shohin bu-

jqësinë si një sektor me risk. Ajo konsiderohet një sektor me informalitet të lartë, që nuk i plotëson dot kërkesat për kolateral të bankës, e për rrjedhojë këto të fundit prirën të jenë më dorështrëguara në miratimin e kredisë ndaj tyre. Shumë prej bizneseve që ushtrojnë aktivitet në fushën e bujqësisë i drejtohen institucioneve financiare jo banka për kredi, ndërsa ata i shohin bankat si shumë burokratike në kriteret dhe procedurat për miratimin e një kredie të re.

Pavarësisht kësaj, ekzistojnë disa nisma që mund ta rrisin mbështetjen ndaj këtij sektori.

Fillimisht, garanciasovrane me një fond prej 3 miliardë lekësh ose 30 milionë eurosh është një instrument i vënë në shërbim të sektorit privat me qëllim lehtësimin e aksesit në financë për fermerët dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Normat që parashi-

kenë tejet të favorshme dhe me mbulim deri në 70% të principalit të kredisë, shuma e së cilës nuk do të kalojë 25 milionë lekë për secilin prej subjekteve aplikuese.

Së dyti, Banka e Zhvillimit do të krijohet për të mbështetur pikërisht ndërmarrjet shqiptare që nuk kanë qasje të mjaftueshme në financim nga tregu tradicional dhe të cilat shpesh përballen me vështirësi në sigurimin e kredive ose investimeve për zgjerim dhe inovacion.

Po ashtu, sektorit bankar shqiptar do t'i shtohet një bankë e re. Banka e Shqipërisë dha së fundmi miratimin paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj Ziraat Bank në vendin tonë. Një bankë e tillë është e specializuar për huadhënien ndaj bizneseve që operojnë në fushën e bujqësisë, ndaj pritet ta rrisë më tej mbështetjen financiare ndaj këtij sektori.

Hapet në Tiranë Java Kulturore e Arabisë Saudite, arti e tradita e një vendi i gjithi për t'u zbuluar

Arti, tradita dhe kultura e Arabisë Saudite u prezantuan në kuadër të Javës Kulturore, që u zhvillua për here te pare në Tiranë gjatë datave 16-20 shtator.

Java Kulturore e Arabisë Saudite, e cila u hap pasditen e se martes tek Pallati i Kongreseve në Tiranë synon të ndër-

i Javës Kulturore Saudite në Tiranë pasqyron përkushtimin e Mbretërisë së Arabisë Saudite për të ndërtuar ura komunikimi kulturor e civilizues me vende të ndryshme të botës, si dhe mishëron vendin e rëndësishëm që kultura zë në Vizionin e Mbretërisë 2030.

dijes, përveç atyre ekzistuese.

Aktivitetet janë ndërtuar në mënyrë të atillë që të nxjerrin në pah ndërthurjet kulturore midis artit saudit dhe atij shqiptar duke treguar se traditat lidhen dhe pasqyrojnë identitete të përbashkëta.

Vizitorët patën mundësinë të zbulojnë nga afër historinë, artin dhe vlerat që e kanë bërë Arabinë Saudite një vend me trashëgimi të pasur dhe një vizion modern drejt së ardhmes.

Në Pallatin e Kongreseve u hap edhe ekspozita me dorëshkrime arabe të rralla, një pasuri e çmuar që ruhet me kujdes në bibliotekat e Mbretërisë.

Ndërsa në Këndet e Punimeve Artizanale, artizanët sauditë demonstuan mjeshtërinë e tyre, duke ofruar mundësinë për të mësuar mbi teknikat tradicionale dhe trashëgiminë kulturore të një vendi i gjithi për t'u zbuluar.

Pjesë e programit ishte edhe ekspozita e instrumenteve muzikore tradicionale.

Në ditët në vazhdim vizitorët do të shijojnë produktet tradicionale të Arabisë Saudite. Nuk do të mungojnë dhe performanca të përbashkëta mes muzikantëve sauditë dhe shqiptarë, si dhe koncerte nga artistë të njohur.

Në vijim të aktiviteteve vijnë dhe shfaqjet e filmave të shkurtër, që sjellin në ekran pasurinë dhe larminë e rajoneve të ndryshme të Arabisë Saudite, duke pasqyruar trashëgiminë, traditat dhe artin e vendit.

Java Kulturore e Arabisë Saudite, e organizuar me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të zhvillohet deri më 20 shtator.

Gratë punojnë, burrat drejtojnë agrobizneset - Trendi po ndryshon, rritet ambicia e gjinisë femërore për të menaxhuar

Bujqësia konsiderohet burimi kryesor i të ardhurave për popullsinë rurale në Shqipëri. Por tradicionalisht gratë kanë qenë të diskriminuara në këtë sektor, pasi u janë lënë në dorë punë të përditshme, në të shumtën e rasteve të papaguara dhe sa i takon drejtimit të agrobizneseve, rol dominant kanë burrat.

Referuar një raporti të publikuar së fundmi mbi rolin e grave në bujqësi në Ballkanin Perëndimor, ku përfshihet edhe Shqipëria del në pah ky gap.

Të dhënat japin një pasqyrë të qartë të shpërndarjes së menaxhereve të fermave nëpër grupmosha të ndryshme, duke nënvizuar mungesën e menaxhereve gra të fermave midis të

anketuarve. Shumë pak gra deklarojnë se drejtojnë fermat e tyre, apo më pak se 4% e grave. Të dhënat tregojnë se të qenit menaxhere biznesi në bujqësi nuk është dukshëm më i lidhur me moshën, pasi përqindja është pothuajse identike në të dy kategoritë e moshave, 18-40 vjeç apo 41 vjeç e sipër.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se gatishmëria për të drejtuar fermën rritet me moshën. Moshë duket të jetë një faktor i rëndësishëm, pasi përqindja e grave mbi 41 vjeç që janë të gatshme të drejtojnë fermën është tre herë më e lartë krahasuar me grupmoshat më të reja (përkatesisht 22% kundrejt 7%).

Kjo mund t'i atribuohet

faktorëve të tillë si përvoja e akumuluar, besimi më i madh ose një mundësi më e lartë për të zotëruar ose menaxhuar një fermë ndërsa moshë ka. Sipas grupeve të fokusit, ngurrimi i fermerëve gra për të udhëhequr shpesh është i lidhur me një mungesë të perceptuar të aftësive dhe përvojës në detyrat e menaxhimit, veçanërisht në mbrojtjen e të korrave, si dhe ndjenjat e përgjegjësisë dhe shqetësimet për paragjykimet në marrëdhëniet e punës.

Një numër i konsiderueshëm grash dhe burrash janë të punësuar në bujqësi, ku vendet e punës janë kryesisht me cilësi të ulët dhe të paguara dobët.



Kina pushton tregun shqiptar, importet u rritën me 21,8% në 7 muaj

Të dhënat e fundit nga INSTAT tregojnë se në korrik 2025 Shqipëria ka shënuar një rritje të ndjeshme të importeve nga Kina dhe Turqia, ndërkohë që shkëmbimet tregtare me Italinë dhe Gjermaninë kanë pësuar rënie.

Eksportet e mallrave arritën në 35 miliardë lekë, duke u rritur me 5,7% krahasuar me korrikun e një viti më parë, por duke shënuar një rënie të lehtë prej 0,5% ndaj qershorit 2025. Ndërkohë, importet arritën në 83 miliardë lekë, një ulje prej 2,4% në krahasim me një vit më parë, por me një rritje mujore të fortë prej 9,1%. Deficiti tregtar i muajit korrik rezultoi 48 miliardë lekë, me ulje prej 7,5% kundrejt korrikut 2024, por me rritje prej 17,3% krahasuar me qershorin 2025.

Në shtatëmujorin e parë të vitit, eksportet kapën vlerën 239 miliardë lekë (+2,6%), ndërsa importet arritën në 515 miliardë lekë, duke shënuar një rënie prej 2,1% në bazë vjetore. Në strukturën e eksporteve, rritjen e kanë udhëhequr grupet “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” (+9,2 pp) dhe “Ushqime, pije, duhan” (+1,1 pp), ndërsa nega-

tivisht kanë ndikuar “Materiale ndërtimi dhe metale” (-6,3 %) dhe “Produkte kimike e plastike” (-0,7 %).

Partnerët tregtarë kanë pasur ecuri të ndryshme. Në korrik,

(-10,3%), Gjermania (-16,6%) dhe Kosova (-21,5%), ndërsa u regjistruan rritje të forta nga Kina (+7,6%), Turqia (+12,0%) dhe Greqia (+5,0%). Në shtatë muaj, importet nga



eksportet u rritën më së shumti drejt Kosovës (+72,5%), Greqisë (+14,8%) dhe Gjermanisë (+0,6%), ndërsa ranë drejt Italisë (-6,4%), Maqedonisë së Veriut (-32,7%) dhe Turqisë (-3,2%). Në shtatëmujor, ulja më e madhe e eksporteve është regjistruar me Italinë (-10%) dhe Maqedoninë e Veriut (-30,1%).

Në frontin e importeve, korriku shënoi rënie nga Italia

Kina janë rritur me 21,8%, duke e kthyer këtë vend në një nga furnitorët më të rëndësishëm të tregut shqiptar, përkrah Greqisë (+2,8%) dhe Spanjës (+14,9%).

Të dhënat tregojnë qartë një zhvendosje të bilancit tregtar: ndërsa partnerët tradicionalë europianë po shënojnë ulje në shkëmbime, Kina po fiton terren të ndjeshëm në tregun shqiptar.



toje ura të forta miqësie përmes artit, traditës dhe historisë mes dy vendeve.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm ministri në detyrë i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja dhe ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Faisal Ghazi Hivzi.

Ministri Gonxhja e cilësoi këtë aktivitet një mundësi në forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve. “Për Shqipërinë, kjo përbën një mundësi të rrallë për t'u angazhuar me një kulturë që ka qenë e largët, por që rezonon me traditat e përbashkëta mesdhetare dhe lindore”, tha Gonxhja.

Ndërsa Ambasadori i Kujdestarit të Dy Shenjtërive në Republikën e Shqipërisë, Faisal bin Ghazi Hifzi tha se, “Organizimi

Ambasadori sqaroi se ky aktivitet përbën një mundësi për t'i prezantuar popullit shqiptar një pamje të plotë të kulturës saudite, përmes aktiviteteve të larmishme që do të përfshijnë: ekspozita artistike dhe artizanale, shfaqje muzikore e teatrale, sesione kulturore, shfaqje kinematografike, si edhe prezantimin e kulinarisë tradicionale saudite me gjithë diversitetin dhe origjinalitetin e saj.

Më tej, ambasadori Hifzi theksoi se organizimi i kësaj jave kulturore vjen në kuadër të forcimit të marrëdhënieve të shkëlqyera midis Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Republikës së Shqipërisë, duke zgjeruar fushat e bashkëpunimit mes dy vendeve për të përfshirë edhe dimensionin kulturor dhe atë të

BUJQËSI

Produktet autentike “Made in Albania” promovohen në tregun baltik

Produktet autentike “Made in Albania” po prezantohen në panairin ndërkombëtar RIGA FOOD 2025, ngjarja më e madhe e industrisë ushqimore në rajonin e Baltikut që po mbahet nga data 4- 6 shtator në Letoni.

Panairi shërben si një platformë kyçe për të shfaqur risitë, trendet dhe zhvillimet më të fundit në fushën agroushqimore, duke mbledhur prodhues, shpërndarës, importues dhe ekspertë të industrisë nga e gjithë Evropa.

Shqipëria është pjesë e këtij panairi prestigjioz me një pavion të dedikuar, ku ekspozohen produktet më përfaqësuese të traditës dhe cilësisë shqiptare, si vaj ulliri, mjaltë, çajra, fruta dhe bimë mjekësore.

Kjo pjesëmarrje synon të promovojë prodhimin vendas në tregjet ndërkombëtare dhe të nxisë bashkëpunime të reja në sektorin agroushqimor.

Agjencia për Zhvillimin e Investimeve në Shqipëri (AIDA) bëri të ditur se interesi i tregut baltik për produktet shqiptare është i madh, duke hapur rrugë për bashkëpunime të reja dhe zgjerim në tregje të huaja.

Në pavionin shqiptar E19/D20, vizitorët kanë mundësinë të shijojnë dhe të njihen nga afër me disa nga produktet më cilësore që ofron Shqipëria.

Sipas AIDA-s, dita e parë e panairit u shënuar nga takime të shumta ku kompanitë



shqiptare patën mundësinë të ndërveprojnë me përfaqësues të tregjeve baltike, duke prezantuar potencialin që ofron Shqipëria si një vend me traditë, cilësi dhe shije të veçantë mesdhetare.

Pjesëmarrja e Shqipërisë

në këtë ngjarje ndërkombëtare është një hap i rëndësishëm për promovimin e produkteve shqiptare në tregjet e huaja, veçanërisht në vendet baltike, ku interesi për produktet bio dhe me origjinë të garantuar është në rritje.

Reçi pret sezonin e gështenjës, zona e njohur për cilësinë dhe shijen e prodhimit

Në fshatin piktoresk të Reçit, banorët janë në pritje të sezonit të gështenjës, produktit më të çmuar të zonës dhe burimit kryesor të të ardhurave për shumë familje. Pyjet e pafundme të gështenjave që rrethojnë fshatin tashmë po marrin ngjyrat e para të vjeshtës.

Kujtim Hysaj banor i fshatit Dukë në zonën e Reçit, shprehet se tani fillon sezoni i gështenjës. Ai tregon se çdo vit prodhon 5 deri në 10 kuintal gështenja, por që nga përhapja e sëmundjes sipas tij, prodhimi ka rënë ndjeshëm.

“...prodhojmë 5 deri në 10 kuintal gështenja. Që kur u përhap sëmundja, prodhohet shumë më pak”, thotë fermeri.


Reçi njihet në mbarë Shqipërinë për cilësinë dhe shijen e veçantë të gështenjave, të cilat çdo vit mbledhen me kujdes nga banorët dhe tregtohen në tregjet e vendit e më gjerë. Përveç rëndësisë ekonomike, gështenja është bërë edhe simbol i identitetit kulturor të fshatit, duke kulmuar me Festën e Gështenjës, që mbledh turistë e vizitorë nga e gjithë Shqipëria.

“Kjo zonë njihet për pro-

dhimin e gështenjës, pasi është dheu, vetë toka dhe ambienti që e prodhon”, thotë fermeri.

Jo vetëm prodhimet bujqësore dhe blegtorale e bëjnë këtë

zonë që të ketë një hov në zhvillimin ekonomik. Sot fshati i Reçit ofron turizëm gjithë vjetor, me natyrë të bukur, sportet e aventurës, traditë dhe kulinari



Fermerët e Myzeqesë rrezikojnë eksportet, pesticidet e ndaluara dhe mungesa e udhëzimeve rrisin shqetësimet për prodhimet

Shumica e prodhuesve të frutave dhe perimeve në Myzeqe punojnë pa mbikëqyrje nga specialistët e bujqësisë. Ata shpesh nuk pyesin

venia janë të izoluar, por jo të rralla. Preparatet e ndaluara nga BE-ja shiten në farmacitë bujqësore, por ato nuk njihen nga fermeri.

t'i udhëzonin se cilat pesticide janë të ndaluara, sidomos në Bashkimin Europian,” thotë specialisti i Bujqësisë, Josif Prifti.

Preparatet organike dhe metodat e luftës biologjike njihen pak, por përdorimi i tyre siguron prodhime të sigurta dhe brenda standardeve. Gabimet vijnë nga çmimi më i ulët i pesticideve në farmacitë bujqësore dhe mosnjohja e dozave të duhura.

“Ky mendoj se është një rast i izoluar. Jo të gjithë fermerët e bëjnë këtë gabim dhe jo e gjithë bujqësia shqiptare është në këtë gjendje, por puna duhet të jetë sa më e organizuar në mënyrë kapitilare,” shprehet z. Prifti.

Tek specat e kthyer nga Sllovenia, fermerët përdorin doza të larta dhe nuk respektojnë kohën e spërkatjes. Nikeli tek pjeshkët erdhi nga preparatet e ndaluara, që fermerët nuk i dinin.

“Duke marrë këshillën e specialistëve, duke përdorur plehra cilësore, pesticide cilësore, edhe bima vjen e shëndetshme. Kjo ul sasinë e spërkatjes së bimës, ul edhe rrezikun e mbingarkesës së bimëve nga pesticidet,” thekson specialisti.

Fermerët e Myzeqesë eksportojnë mijëra ton frutash dhe perimesh në BE çdo ditë, por rastet e fundit tregojnë se duhet më shumë kontrolle përpara se prodhimet të shkojnë në treg.



agronomët për përdorimin e pesticideve, por u besojnë këshillave të shitësve në farmacitë bujqësore. Rastet e kthimit të pjeshkëve nga Kroacia dhe të specave nga Sllo-

“Fermerët, duke u nisur nga dëshira e mirë që ta bëjnë punën sa më saktë, i marrin pesticidet me udhëzimet e shitësve, por gabimi është që nuk punojnë me specialistët, të cilët do

Kujdesi për bagëtitë në dimër, blegtorët përgatisin bazën e duhur ushqimore

Dimri është periudha më kritike për blegtorinë, pasi mungesa e kullotave e bën ushqimin e kafshëve të varet plotësisht nga baza ushqimore e përgatitur paraprakisht.

Fermerët duhet të sigurojnë sasi të mjaftueshme dhe cilësore ushqimi për të garantuar shëndetin dhe prodhimtarinë e tufave.

Përgjegjësi i punës racore në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) bën me dije se kanë siguruar bazën ushqimore, ndërsa këshillon fermerët mbi ushqimin që duhet të përzgjedhin.

“Paraprakisht në Drejtorinë e Teknologjive Blegtorale në QTTB-në e Korçës është grumbulluar baza ushqimore për dimërimin e kafshëve të bërthamave racore që mbarëshohen këtu. Është llogaritur një periudhë 6-mujore që kafshët mund të qëndrojnë të trajtuara në grazhd me këto ushqime. Baza ushqimore është grumbulluar në një hangar, ku është eliminuar pjesa e lagështirës. Fermerët, të cilët mbarëshojnë kafshë, e

kanë ezauruar këtë pjesë më së shumti,” tregon Lazart Suraj, përgjegjës i sektorit të punës racore në QTTB Korçë.

Pra, silazhimi është një ushqim i konservuar për kafshët që nevojitet për periudhën e dimrit dhe ka një vlerë shumë



Ai thotë se tani është koha e përshtatshme për të përgatitur edhe silazhin.

“Për fermerët që bëjnë silazh, që mbarëshojnë kryesisht gjedhë, është periudha e fazës së qumësht-dyllit të misrit. Në këtë fazë duhet kryer kjo lloj procedure [silazhimi] për të siguruar një ushqim të konservuar gjatë periudhës së dimrit.

të madhe, si energjetike, edhe proteinoze, për të mbarështuar kryesisht gjedhët,” thotë z. Suraj.

Sigurimi i ushqimit në kohë, ruajtja e tij në kushte të përshtatshme dhe shpërndarja me racione të balancuara ndihmojnë që kafshët të kalojnë dimrin pa humbje në prodhim dhe me shëndet të mirë.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



AGROTURIZËM

#EU4Nature: Parqet e Shqipërisë në zonat e mbrojtura “bëhen digjitale” - Një hap përpara për natyrën dhe turizmin



Lumi Vjosë. Foto: UNDP Albania

Peizazhet e virgjëra të Shqipërisë - ujërat kristal të lumit Vjosë, pishat që shushurijnë në Parkun Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” dhe perlat liqenore akullnajore, me pyjet shekullore dhe livadhet e famshme të Parkut Lurë-Mali i Dejës - po tërheqin gjithnjë e më shumë turistë nga e gjithë bota. Vetëm në një vit, mbi 5 milionë vizitorë kanë shkelur në zonat e mbrojtura të vendit.

Falë projektit #EU4Nature, eksplorimi i këtyre mrekullive natyrore është bërë më i lehtë, më “smart” dhe më miqësor me mjedisin. Digjitalizimi i shërbimeve shënon një hap të madh që pritet të revolucionarizojë menaxhimin e parqeve dhe ekoturizmin në Shqipëri.



Parku Kombëtar i Shebenikut. Foto: UNDP Albania

Imagjinoni këtë: jeni buzë Parkut Kombëtar të Shebenikut, gati për një ecje mes pyjeve të paprekura. Nuk keni para në xhep? Asnjë problem. Parku ju lëshon një faturë elektronike dhe ju mund të paguani përmes telefonit. Me Sistemin e Unifikuar të Faturimit dhe Biletimit Elektronik, mund të merrni një biletë online dhe të paguani për ankorimin e varkës në Porto Palermo apo për një udhëtim me

Pikat e grumbullimit në Divjakë kanë rifilluar eksportet pas disa ditëve ndërprerjeje. Nga sot, çdo arkë me prodhime bujqësore ka etiketën e identifikimit, ku shënohet emri i fermerit, NIPT-i dhe zona e prodhimit, duke rritur përgjegjësinë për përdorimin e pesticideve.

“Kjo etiketë përfaqëson fermerin, dhe shënohet kur sjell mall. Në momentin kur fermeri përfundon vjeljen e mallit, pra dorëzimin e mallit total, bëhet fatura e blerjes dhe shitjes e cila firmoset nga ana e pikës grumbulluese, vetë fermeri dhe transportuesi”, thotë Mariglen Tabaku, ekonomist Divjakë.

Prodhimet, kryesisht spec jeshil, po paketohen në magazinat frigoriferike për t'u dërguar drejt vendeve të Bashkimit Europian. Aktualisht

eksportet shkojnë kryesisht në Çeki, Poloni, Kroaci dhe Serbi. Por eksportuesit thonë se ko-

kajak në lumin Vjosë, thjesht me një prekje në pajisjet POS portative të vendosura në pikat kyçe të çdo parku.

Operatorët turistikë, guidat e licencuara dhe operatorët e eventeve mund të kontaktojnë administratën e parkut dhe të marrin faturën elektronike në kohë reale, drejtpërdrejt nga telefoni i tyre.

Ky sistem mbulon mbi 95 shërbime - nga zhytjet nënujore deri te kampingjet ekologjike - duke i ofruar vizitorëve akses të shpejtë në të gjitha aktivitetet që ofrojnë zonat e mbrojtura. Më pak kohë për procedura dhe pagesa, më shumë kohë për të shijuar biodiversitetin mahnitës të Shqipërisë.

Por digjitalizimi nuk është vetëm çështje komoditeti - ai është një mjet i fuqishëm për ruajtjen e natyrës. Sistemi siguron mbledhje më të plotë të tarifave dhe transparencë mbi të ardhurat, të cilat reinvestohen drejtpërdrejt për ruajtjen e ekosistemeve.

“Digjitalizimi i Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë është një hap shumë i rëndësishëm. Duke lehtësuar aksesin në parqe, jo vetëm që po e bëjmë më të thjeshtë lidhjen e vizitorëve me natyrën, por gjithashtu po sigurojmë transparencë mbi të ardhurat e mbledhura. Çdo biletë elektronike mbështet drejtpërdrejt përpjekjet për ruajtjen e natyrës - nga rikthimi i habitateve deri te mbrojtja e faunës së egër. EU4Nature po ndërton një të ardhme të qëndrueshme ku turizmi dhe natyra ecin krah për krah.” - Violeta Zuna, Menaxhere e Projektit EU4Nature



Për të garantuar funksionimin e plotë të sistemit, stafi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ka marrë trajnime praktike. Foto: UNDP Albania

Për të garantuar funksionimin e plotë të sistemit, stafi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ka marrë trajnime praktike. Rezultati?

Një përvojë më e thjeshtë për vizitorët dhe një atraksion shtesë për udhëtarët drejt 10 zonave pilot përfshirë Parkun Kombëtar të Lumit Vjosë, Malin e Dajtit dhe Parkun Natyror

të Porto Palermos.

Akses më i lehtë dhe pagesa të thjeshtuara nënkuptojnë më shumë vizitorë që kontribuojnë për natyrën, pasi çdo e ardhur e mbledhur do të rikthehet në mbrojtjen e këtyre habitateve të brishta.

Shqipëria është “shtëpia” e disa prej lumenjve të fundit të egër dhe pyjeve të paprekura të Evropës. Megjithatë, kërcënime si zgjerimi urban dhe ndryshimet klimatike mbeten të pranishme. EU4Nature, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Sida, dhe i zbatuar nga UNDP dhe Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, po i adreson këto sfida me veprime konkrete.



Bredhi i Hotovës-Dangëlli. Foto: UNDP Albania

Qëllimi është i qartë: mbrojtja e 25% të tokës dhe detit të Shqipërisë deri në vitin 2030, nga 21.5% që është aktualisht, duke u përafruar me standardet e rjetit Natura 2000 të BE-së. Me instrumente si Mjeti i Matjes së Efikasitetit të Menaxhimit (METT) dhe zgjidhje të bazuara në natyrë, projekti po rikthen habitatet e degraduara dhe po fuqizon komunitetet lokale.

Sistemi digjital është një hallkë kyçe në këtë mision: formalizon pagesat, rrit besimin e vizitorëve, forcon kontrollin dhe siguron llogaridhënie. Më shumë vizitorë dhe një sistem pagesash i thjeshtë përkthehen në më shumë të ardhura për menaxhimin e parqeve, financimin e trajnimeve për rojet dhe nismave të rigjallërimit të natyrës. Për komunitetet lokale, kjo sjell vende pune të qëndrueshme - si guida, zejtarë dhe operatorë eko-bujtinash - që lidhen drejtpërdrejt me shëndetin e tokës.

Duke mbrojtur burimet natyrore të Shqipërisë, #EU4Nature jo vetëm që ruan peizazhet unike, por edhe mbron të ardhmen e komuniteteve që jetojnë pranë tyre.

Prandaj, merrni atletet dhe zbuloni natyrën e egër të Shqipërisë - tani edhe më lehtë dhe më “digjitale” se kurrë!

Në Divjakë rinisin eksportet - Fermerët vendosin etiketa, eksportuesit ankohen për kostot e larta të analizave



stot e analizave laboratorike janë shumë të larta dhe shteti duhet t'i garantojë laboratorë



më të sigurt dhe më të lirë. “...është një grup që kemi formuar me fermerët tanë dhe

kemi kaq vjet që konsultohemi me njëri-tjetrin dhe dimë se çfarë duan”, thotë Elton Biti,

eksportues në Divjakë.

Falë klimës së ngrohtë, fermerët kanë prodhime edhe në vjeshtë dhe këtë vit pritet një sasi më e madhe se një vit më parë. Eksportuesit kërkojnë që të zgjerohet harta e tregjeve ku shkojnë produktet shqiptare.

“Po fillon kulmi i prodhimit. Pikat e prodhimit e plotësojnë kërkesën dhe kemi dhe më shumë se sa eksportojmë. Kemi më shumë pasi aktualisht nuk ka kërkesë të madhe nga vendet që eksportojmë pasi edhe ato kanë prodhimet e tyre”, thotë Mariglena Biti, eksportuese në Divjakë.

Rastet e kthimit të domates dhe specit nga Kroacia dhe Sllovenia për shkak të pesticideve tronditën fermerët, duke sjellë ndërprerjen e eksporteve për dy javë dhe rënie të ndjeshme të çmimeve.

INFORMACIONE

Pjeshkët e Barbullinjës në treg me standarde të BE, fermerët kërkojnë hetim pas kthimit nga Kroacia

Pjeshkët e Barbullinjës po dalin në treg normalisht këto ditë dhe çmimi i tyre është i kënaqshëm për fermerët, edhe pas lajmit për kthimin e rreth 5500 kilogramëve nga Kroacia.

Vëllezërit Denis dhe Gazment Murati janë duke vjelë prodhimin e stinës për eksport, të bindur se fruti i tyre i përmbush standardet e BE. Ata theksojnë se çdo shërbim në plantacion është bërë me këshillimin e specialistëve të bujqësisë. Edhe djali i tyre, Enea, e pohon këtë ndërsa shijon frutin.

“Ne pjeshkat i bëjnë ashtu siç do të dëshironim ne ti konsumonim”, u shpreh Enea Murati.

Kthimi i një sasive prodhimi nga Divjaka është rasti i parë për pjeshkën, por qe ka penalizuar në fakt të gjithë fermerët. Ata kërkojnë që çështja të hetohet nga strukturat e shtetit, por puna e ndershme të mos njolloset.

“Kemi kaq vite që punojmë e dimë kur i spërkasim, ka gabuar njëri dhe digjemi të gjithë ne të tjerët”, u shpreh fermeri, Denis Murati.

“Produktet tona janë shumë

të mira sepse jkemi vite që punojmë, kemi specialist të caktuar për këtë, edhe ilaçet që marrim janë të BE”, tha Gazment Murati, fermer.

Prej 15 vitesh, pjeshkat e Barbullinjës plotësojnë tregun vendas dhe mbeten pjesë e rëndësishme e eksporteve drejt vendeve të BE dhe më gjerë.



“Nikel në pjeshkë me origjinë nga Shqipëria” - Kroacia bllokon dhe asgjëson mbi 5500 kg produkt

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit njofton se më datë 22.08.2025, Shqipëria është njoftuar nga Sistemi RASFF, në kategorinë Njoftim për refuzim në kufi me numër reference 2025.6367 me temë: “Nikel në pjeshkë me origjinë nga Shqipëria”, të njoftuar nga Kroacia.

Nga analizat e kryera në

shtetin kroat, është konstatuar prania Nikel mbi normën e lejuar.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, rasti i kaloi për ndjekje strukturave të Drejtorisë Rajonale të AKU Fier.

Sipas informacionit u krye inspektim në OBU eksportues, ku rezultoi se nuk ka gjendje të produktit në magazinat e tij.

Subjekti disponon sistem gjurmueshmërie, ku u verifikua se produkti është dërguar i gjithi për eksport dhe nuk është shpërndarë në tregun vendas.

Sasia prej 5562 kg pjeshkë janë dërguar drejt Kroacisë, ku dhe janë asgjëuar pas rezultatit të analizës laboratorike. Rasti iu referua dhe AKVMB për masa të mëtejshme.

Kujdesi ndaj bagëtive të imëta, është periudha e tyre e vaksinimit, kujdes gjatë mbarështimit

Kujdesi i rregullt për bagëtitë e imta është thelbësor për shëndetin e tufës dhe prodhimtarinë e saj. Specialistët e bujqësisë dhe veterinarisë theksojnë se vaksinimi i rregullt është masa më e sigurt për të parandaluar sëmundjet ngjyëse, të cilat shpesh shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike për fermerët. Vaksinimet kryesore që duhet të kryhen në këtë periudhë janë kundër enterotoksemisë dhe sëmundjeve parazitare.

“Bagëtitë e imëta dhe kryesisht delet ka përfunduar ciklin e laktacionit, sezoni i këtij momenti ka të bëjë me disa parazitatoza por edhe me një lloj vaksinimi që duhet kryer”, u shpreh Lazart Suraj, Përgjegjës i sektorit të punës racore, QTTB Korçë.

Edhe mbarështimi i dhive kërkon vëmendje të veçantë thotë Suraj.

“Fermerët të cilët mbarësh-

Specialistët e blegtorisë shprehen se një fermë e menaxhuar me kujdes, ku respektohen rregullat e vaksinimit dhe të



tojnë dhi, duhet që të fusin në riprodhim reprodutorët me vlera gjenetike më të mira që disponohen”, tha ai.

ushqyerjes, është garancia për tufë të shëndetshme, prodhim të lartë dhe siguri ushqimore për konsumatorët.

Rritet interesi për blegtorinë - Zgjerohen sipërfaqet me foragjere në Bashkinë Maliq

Interesi në rritje për blegtorinë në bashkinë e Maliqit ka sjellë një zgjerim të ndjeshëm të sipërfaqeve të mbjella me kultura foragjere.

Aktualisht, në këtë zonë numërohen rreth 45 mijë krerë të imta dhe 8 mijë gjedhë, shifër që dëshmon rëndësinë gjithnjë e më të madhe të këtij sektori për ekonominë lokale. Kërkesa në rritje e tregut dhe çmimet e favorshme për qumështin dhe mishin janë ndër arsyt kryesore që kanë nxitur zhvillimin e blegtorisë.

Arben Dulellari, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Maliq u shpreh për RTSH se “Janë 45 mijë krerë të imta, janë rreth 8 mijë gjedhë që mbarështohen në territorin tonë, të Bashkisë Maliq. Sigurisht interesi

i blegtorëve ka filluar të rritet sepse dhe çmimet e tregtisë së mishit dhe qumështi kanë qenë të favorshme për blegtorët. Me rritjen e numrit të blegtorisë ka



ardhur dhe rritja e sipërfaqes me foragjere, kryesisht e jonxhës dhe misrit.

Një pjesë e fermave kanë

investuar edhe në teknologji bashkëkohore, duke krijuar kushte më të mira për rritjen e gjedhëve dhe përmirësimin e prodhimit. Ky trend shi-

het si një mundësi e mirë për rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe fuqizimin e sektorit bujqësor në Maliq.

Fermerët drejt formalizimit, 19 milionë euro fatura në periudhën qershor-korrik

Administrata Tatimore raportoi një rritje të dukshme të vetëfaturimit nga fermerët, një hap i rëndësishëm në procesin e formalizimit dhe përmirësim-

udhë të vitit të kaluar, duke arritur në 19 milionë euro.

Ky progres i rëndësishëm vjen si rezultat i një angazhimi në rritje nga ana e

tregon se gjithnjë e më shumë fermerë po përmbushin detyrimet fiskale, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më të rregullt ekonomik.

Një element kyç i këtij procesi është përmirësimi i gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore. Rritja e numrit të autofaturave është një hap i rëndësishëm për forcimin e zinxhirit ushqimor, duke ndihmuar në kontrollin më të madh mbi burimet dhe prodhimin e ushqimeve. Kjo kontribuon në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së produkteve që arrijnë tek konsumatorët, si dhe në uljen e informalitetit.

“Shifrat tregojnë qartë se formalizimi i zinxhirit ushqimor po ecën me ritmet e shpejta, duke rritur transparencën dhe forcuar bazat për një ekonomi më të konkurrueshme”, bën të ditur DPT.



it të transparencës në sektorin e bujqësisë në Shqipëri.

Sipas të dhënave të fundit, vlera e faturimeve gjatë periudhës qershor-gusht, ka shënuar një rritje prej 86,5% krahasuar me të njëjtën peri-

fermerëve për t'u regjistruar dhe për të përdorur sistemin e vetëfaturimit.

Sipas Administratës Tatimore, 57% e fermerëve tani janë të aktivizuar në këtë sistem, një rritje e ndjeshme që

Mirditë, grante deri në 500 mijë lekë për të rinjtë me ide inovative në turizëm

Platforma e Inovacionit në Turizëm, TIP Mirdita, ka hapur thirrjen për aplikime për të rinjtë që duan të zhvillojnë një sipërmarrje inovative në fushën e zhvillimit të turizmit rural.

E mbështetur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe projekti gjerman për Zhvillimin e qendrueshëm rural, hapja e thirrjes për financimin grant, është një mundësi e mirë për të gjithë të rinjtë e moshës 18–35 vjeç që jetojnë në 7 njësitë administrative të Bashkisë Mirditë.


Fokus kryesor është zhvillimi i sipërmarrjeve në turizëm, bujqësi, blegtori, bletari dhe artizanat në zonat: Rubik, Rrëshen, Fan, Selitë, Orosh, Kaçinar dhe Kthell.

TIP Mirdita ofron grante

deri në 500,000 lekë për realizimin e ideve tuaja; mentorim profesional nga ekspertë të fushave përkatëse si dhe

më 17 shtator deri më 17 tetor 2025.

Në fokus është nxitja e zhvillimit ekonomik lokal



mundësi për të ndërtuar një sipërmarrje të qëndrueshme në komunitetin tuaj.

Aplikimit kanë nisur nga sot

përmes fuqizimit të të rinjve me ide inovative dhe të qëndrueshme në sektorët kyç të zonës.

BUJQËSIA NË RRETHE

Kukës - Kulturat bujqësore të vjeshtës, fermerët në sezonin e vjeljes së rrushit

Aktualisht fermerët janë në sezonin e vjeljes së rrushit.

Sipas agronomit Faik Stanisha, kjo është periudha kur duhet të merret prodhimi në kohë, në mënyrë që të mos dëmtohet nga kushtet atmosferike ose vonesa në procesin e vjeljes.

“Rrushi është pjekur. Nuk pritët më që të piqet. Rrushi, mollët, pemët frutore në përgjithësi. Rrushi nuk pritët që të fitojë më tepër ëmbëlsi. Duhet të marrin masat ta grumbullojnë,” këshillon agronomi.

Nga mesi i shtatorit dhe në vijim pritët të nisë puna për mbjelljen e farërave të vjeshtës. Para se të hidhen farat, thekson agronomi, është e domosdoshme që toka të përgatitet siç duhet, të lërohet dhe të trajtohet për t’u bërë e përshtatshme për mbjellje.

“Mbjellja e thekrës duhet të kishte përfunduar, të paktën deri më 20 shtator. Për grurin duhet të përgatitet toka. Unë s’besoj që ka rënë shi bollshëm, por duhet të fillojnë të përgatitin tokën, plugimin,” thotë z. Stanisha.

Sipas tij, këtë vit përgatitjet për mbjelljet kanë ardhur

më vonë se zakonisht. Shkaku kryesor lidhet me kushtet at-

mosferike, gjë që ka vonuar ritmin e punës në fshat.



Sezoni i ullirit me rendiment të ulët, shiu i pranverës dëmtoi prodhimin. Cilësia mbetet e garantuar

Në prag të sezonit të vjeljes së ullirit, ekspertë dhe kultivues parashikojnë ulje të ndjeshme të rendi-

toi pemët në kohën që lulëzonin.

Lefter Tabaku ka 500 rrënjë ullinj në Mallakastër



mentit. Shkak duket se është bërë moti i papërshtatshëm i pranverës së shkoj, që sipas kultivuesve të ullirit, dëm-

dhe thotë se prodhimi këtë vit pritët të jetë 40% më i ulët.

“Ndikuan shirat që ra në

kohën e lulëzimit”, tha ai.

Në pritje të një rendimenti të ulët, fermerët parashikojnë rritje të çmimit të vajit të ullirit, por edhe shitjen e sasisë që mbeti stok sezonin e kaluar pas rënies së eksporteve.

“Unë në shtëpinë time kam një ton vaj dhe shpresoj që të na dali eksporti që ta shesim”, tha Tabaku.

Ndikimi i kushteve klimaterike këtë vit përkon me uljen e prodhimit për shkak të natyrës periodike të pemës së ullirit. Ekspertët e bujqërisë gjithsesi bëjnë thirrje për kryerjen e shërbimeve në plantacionet me ullinj, me qëllim maksimizimin e prodhimit për vitin pasardhës.

“Sivjet është më dobët në krahasim me vitet e tjera, Unë këshilloj të marrin masa spër ujëmbledhësat, pastrimin e parcelave dhe plehërimin organik”, tha eksperti i bujqësisë Ladi Pashai.

Në qarkun e Fierit numërohen rreth 2.9 milionë rrënjë ulliri, të përqendruara kryesisht në Cakran, Dushk, Kurjan, Fiershegan, Frakull dhe Mallakastër.

Më i përhapuri është varieteti kaninjt me rreth 50% të sipërfaqes, pasuar nga Frantoio (20%), Koronek (10%), ndërsa Lecino, Kripsi i Beratit zënë nga 5% secili.

Prodhimi i perimeve në Devoll, patatet dhe qepët tregtohen me çmim më të ulët nga viti i kaluar

Në bashkinë e Devollit, prodhimi i perimeve këtë vit ka njohur rritje të ndjeshme, sidomos për qepën dhe patatën.

lartë se një vit më parë.

“Ka filluar vjelja e qepës, e patates. [Qepa] po shkon në treg me një çmim të lever-



Sipërfaqet e mbjella me këto kultura bujqësore janë shtuar, duke bërë që edhe prodhimi total të jetë më i

dishëm. Si rezultat i çmimit të lartë që ishte vitin e kaluar, u rrit rreth 20 për qind sipërfaqja dhe kjo bëri që për këtë vit të

kemi një superprodhim dhe një ulje të çmimit të tregtimit të qepës,” thotë Ylver Bylykbashi, përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Bashkinë e Devoll.

Kjo rritje ka sjellë një ofertë më të madhe në treg, duke ndikuar edhe në uljen e çmimit për konsumatorët.

“Në rast se vitin e kaluar qepa tregtohej me rreth 35–40 lekë, sot tregtohet me 27–30 lekë. Patatja ka ruajtur trendin e vitit të kaluar,” tregon z. Bylykbashi.

Qepa dhe patatja janë dy produkte bazë të tryezës së përditshme, ndërsa fermerët e zonës po punojnë për të siguruar cilësi dhe sasi të qëndrueshme.

Sezoni i vjeshtës në bujqësi, fermerët në Libohovë nisin plugimin e tokës

Në Libohovë, fermerët e zonës sapo kanë mbyllur një nga periudhat më intensive të vitit, vaditjen e misrit.

Tani, me mjetet bujqësore dhe energjinë e zakonshme, ata kanë nisur plugimet për të përgatitur tokën për kulturat e vjeshtës. Ky është një hap i rëndësishëm për të siguruar një sezon të mirë prodhimi, pavarësisht sfidave që bujqësia përballet çdo vit.

“Rënia e reshjeve të fundit ka favorizuar kushtet për fillimin e plugimeve për stinën e vjeshtës, për mbjelljen e kulturave që mbillen në vjeshtë. Ka filluar plugimi për mbjelljen e kulturave foragjere, kryesisht tërshërë, e cila shërben për sigurimin e bazës ushqimore gjatë periudhës së dimrit. Në fshatrat e fushës, kryesisht në Bulo, në Li-



bohovë dhe Nepvravishtë është mbjellë një sipërfaqe rreth 60 hektarë me kulturën e tërshërës për hasëll,” u shpreh specialisti i bujqësisë, Filip Zëra.

Këto ditë shënojnë fillimin e një faze të re pune, ku çdo

hektar do të përgatitet me kujdes për mbjelljet e vjeshtës. Për ta, kjo është jo vetëm një detyrë e përvitshme, por edhe një garanci që puna të mos shkojë dëm, që të sigurojnë një prodhim të kënaqshëm.

Nis puna për ballkonet panoramike në të 12 qarqet, nxitje turizmit natyror

Shqipëria do të pasurohet me një rrjet të ri ballkonesh panoramike në zonat e mbrojtura, përmes një projekti të ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), i cili synon të ofrojë për vizitorët eksperiencë turistike më të plota, ndërgjegjësuere dhe edukative në natyrë.

AKZM bën të ditur se, pro-

jekti i titulluar “Ballkone panoramike në rrjetin e zonave të mbrojtura: studim, përmirësim, mirëmbajtje”, do të shtrihet në 12 qarqet e vendit dhe do të realizohet në pika strategjike me vlera të larta natyrore dhe peizazhore, si: Kapinovë (Berat); Lugina e Lurës (Dibër); Divjakë-Karavasta (Fier); mali i Kallabakut (Kukës) dhe disa të tjerë.

Në vijim të projektit është zhvilluar edhe takimi i parë teknik me ekspertët për hartimin e projekteve, çka shënon nisjen zyrtare të punës për realizimin e këtij vizioni natyror dhe turistik.

Ballkonet panoramike do të jenë struktura të lehta, të ndërtuara me materiale ekologjike dhe me ndikim minimal në mjedis.

Ato do të përdoren jo vetëm për vëzhgim të natyrës, por edhe për informim, edukim dhe ndërgjegjësim të vizitorëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore.

Kjo nismë është pjesë e një strategjie më të gjerë për të zhvilluar infrastrukturën turistike në zonat e mbrojtura, duke nxitur diversifikimin e ofertës turistike të Shqipërisë, përtej destinacioneve tradicionale bregdetare.



KËNDI I EKSPERTIT

Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari
dhe Planifikues Urban Ema Meçollari

